



---

**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

# **RAPORT**

## **PËR VETEVALUIM TË**

### **FAKULTETIT EKONOMIK**

**Tetovë, viti 2021**

**Fakulteti Ekonomik-Економски факултет-Faculty of Economics**  
Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia  
[www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) – e-mail: [econ@unite.edu.mk](mailto:econ@unite.edu.mk)

# PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I EVALUIMIT.....	3
2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT.....	4
2.1. Historiku .....	4
2.2. Plani strategjik .....	5
3. STRUKTURA E FAKULTETIT.....	7
3.1. Organogrami .....	7
4. PROGRAMET STUDIMORE TË FAKULTETIT EKONOMIK .....	10
5. VEPRIMTARIA MËSIMORE .....	14
5.1. Struktura e kuadrit mësimor.....	14
6. STRUKTURA E STUDENTËVE .....	19
6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike.....	19
6.2. Struktura e studentëve në ciklin e dytë të studimeve (master).....	24
6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës .....	28
7. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE .....	28
8. REALIZIM I ORËS MËSIMORE NË KUADËR TË PROGRAMEVE STUDIMORE .....	33
8.1. Anketimi i studentëve për realizim të orës mësimore në kuadër të programeve studimore ..	33
8.2. Realizimi i ligjëratave .....	34
9.SWOT ANALIZA DHE KONKLZIONI .....	37

# **RAPORT I VETEVALUIMIT: FAKULTETI EKONOMIK 2016-2019**

## **1. QËLLIMI I EVALUIMIT**

Procesi i evaluimit të brendshëm ka për qëllim kryesor rritjen e cilësisë, të qenët konkurrues në treg dhe studentëve t'u ofrohen programe në përputhje me universitetet tjera në rajon dhe më gjerë. Po ashtu nëpërmjet evaluimit individual të pedagogëve tentohet të detektohen mangësitë dhe përparësitë në procesin mësimor me qëllim që të njëjtat të përmirësohen ose të zhvillohen.

Raporti i vetevaluimit të Fakultetit Ekonomik trajton këto pjesë:

1. Përshkrimi i fakultetit (historiku)
2. Struktura e fakultetit
3. Veprimtaria mësimore
4. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor
5. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike
6. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte
7. Rezultatet e evaluimit të orës mësimore
8. Konkluzioni
9. Shtojca

## 2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

### 2.1. Historiku

- Fakulteti Ekonomik, si pjesë e Universitetit të Tetovës, u themelua më 17 dhjetor të vitit 1994 si iniciativë e intelektualëve shqiptarë, të shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme apolitike dhe të gjithë dashamirësve të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë. Nga ky këndvështrim, zhvillimin si dhe veprimtarinë e UT-së mund ta ndajmë në dy periudha: 1994-2003 periudha historike e krijimit të Fakultetit Ekonomik si pjesë e Universitetit të Tetovës.
- Periudha: 2004-2010 periudha e zhvillimit institucional të Fakultetit si pjesë e Universitetit të Tetovës dhe koha e modernizimit akademik dhe fizik. Në këtë periudhë Fakulteti Ekonomik nga gjendja e emergjencës filloi të kalojë në shkallën e reformimit akademik, konceptual dhe institucional. Fakulteti Ekonomik funksionon që nga themelimi i Universitetit të Tetovës dhe në këtë periudhë dhjetëvjeçare, 1994-2004, funksiononte Ekonomia e përgjithshme si drejtim i vetëm me kohëzgjatje studimesh 4-vjeçare. Fakulteti Ekonomik vazhdoi të funksionojë në të njëjtën mënyrë edhe pas zyrtarizmit në vitin 2004.
- Në vitin 2007, në Fakultetin Ekonomik u akredituan katër drejtime, edhe atë Ekonomi Biznes, Financa - Kontabilitet, Marketing - Menaxhment dhe Turizëm me kohëzgjatje studimi 3-vjeçar. Duke marrë parasysh nevojat gjithnjë e në rritje të popullatës për arsim të lartë në vendin tonë, me qëllim që t'ju ofrojmë të rinjve të mund të shprehin potencialin e tyre, por në të njëjtën kohë edhe me ndryshimet në Ligjin për arsim të lartë në vitin 2008, programet studimore të Fakultetit Ekonomik hapën grupe të disperzuara në qytete të ndryshme në R. e Maqedonisë edhe atë në Strugë<sup>1</sup> dhe në Shkup<sup>2</sup>. Këto studime të disperzuara aktualisht janë në pushim për regjistrim të studentëve të rinj kurse vendimi për pushim të regjistrimeve të studentëve të rinj nëpër disperzime është për arsye të rritjes së cilësisë.

Sot Universiteti i Tetovës ka shënuar të arritura të mëdha në të gjitha drejtimet. Ai është ngritur tashmë në një institucion arsimor dhe shkencor me përmasa kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare duke tërhequr kah vetja profesoratin më të mirë të vendit dhe rajonit, figurat më eminente të arsimit, shkencës dhe kulturës shqiptare në përgjithësi me një infrastrukturë dhe nivel të lartë të cilësisë së mësimdhënies dhe me avantazhe në raport me konkurrencën.

Avantazhet tona qëndrojnë në infrastrukturën që e përbëjnë sallat, laboratorët, amfiteatrot, programet studimore bashkëkohore në funksion të kërkesave të tregut dhe stafin akademik të kualifikuar që përdorin literaturën më bashkëkohore.

Fakulteti Ekonomik aktualisht është i organizuar në 5 programe studimore:

- Ekonomi Biznesi
- Financa Kontabilitet
- Marketing Menaxhment
- Turizmi dhe
- Biznes Ndërkombëtar

Këto programe studimore janë të organizuara sipas standardeve më bashkëkohore, procesit të Bolonjës dhe Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) të organizuara me akreditimin 4+1+3. Si përmbledhje në kuadër të Fakultetit Ekonomik zhvillohet mësimi në ciklin e parë, në ciklin e dytë kurse nga viti akademik 2015/2016 zhvillohen edhe studimet e ciklit të tretë.

## **2.2. Plani strategjik**

Plani strategjik paraqet një strukturë, i cila ngërthehen një sërë aktiviteteve që do të ndërmerren në Fakultetin Ekonomik në planin afatmesëm dhe afatgjatë në përputhshmëri me perspektivat vizionare dhe misionin që duhet realizuar për të arritur qëllimet e institucionit tonë.


Në pika më të shkurta paraqesim strukturën e aktiviteteve si më poshtë:

- Realizim të programeve studimore konform Ligjit për arsim të lartë dhe kërkesave të tregut bazuar në bashkëpunim edhe me komunitetin e bizneseve;
- Përkujdesje maksimale në avancimin e stafit akademik me qëllim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kyçjes së tyre në hulumtime shkencore nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe publikime të punimeve cilësore në revista prestigjioze të ranguar në rrafshin ndërkombëtar;
- Është paraparë që të jemi pjesë e komunikimit, të detektimit dhe ofrimit të zgjidhjeve rreth problematikave ekonomike që do të paraqiten në periudhën vijuese. Këto aktivitete mendohet të realizohen përmes seminareve, debateve shkencore dhe profesionale, konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Stimulimi nëpërmjet motivimit si dhe kultivimi i arritjeve akademike, mësimore dhe shkencore të stafit dhe studentëve;
- Rritja e normës së informimit të studentëve, stafit akademik dhe administrativ përmes implementimit të ERP sistemeve, forcimin e bashkëpunimit me studentët dhe bizneset përmes Qendrës për Karrierë dhe rritjen e mundësive për kyçjen e studentëve në tregun e punës;
- Evaluimi i vazhdueshëm i procesit mësimor, realizimi i kurrikulave dhe qëllimeve të programit studimor;
- Mbështetja e studentëve me sukses të dalluar për mobilitet në përputhje me rregullat që parasheh sistemi i Bolonjës i aplikuar në procesin mësimor tek institucioni ynë dhe mundësi për punësim të tyre.

### 3. STRUKTURA E FAKULTETIT

#### 3.1. Organogrami

Në vazhdim në një paraqitje skematike do të paraqesim strukturën organizative të Fakultetit Ekonomik



## ***Deskriptorët***

Në të gjitha drejtimet e Fakultetit Ekonomik studimet zgjasin 4 vjet dhe gjithsej grumbullohen 240 (ECTS) kredi. Procesi mësimor realizohet me mësim teorik, praktik dhe gjithashtu do të realizohet mësimi klinik edhe atë sipas sistemit të Bolonjës të akredituar në vitin 2012.

Numri i kredive për çdo lëndë shtrihet prej 2 deri në 8 ECTS, si dhe në fund të studimeve studentët përgatisin temë diplome, e cila përmban 6 kredi.

Mësimi realizohet në dy mënyra: i rregullt (full-time) dhe me korrespondencë (part-time). Studentët ndjekin mësimin në lëndët obligative dhe lëndët zgjedhore. Lëndët përfshijnë kredi, që për afërsisht korrespondojnë me 25-30 orë, nga kohëzgjatja e mësimdhënies së ligjëratave. Gjithashtu, në të gjitha drejtimet, në afatet e parapara të semestrave përkatës realizohen kolokuiumet për çdo lëndë apo provimet në afatet e caktuara.

Çdo vit duhet të fitohen 60 kredi për 1500-1800 orë në vit. Informata më të detajuara për politikën e kredive mund të merren në broshurën e Universitetit. Lëndët ndahen në njësi semestrale. Studentët duhet t'i kryejnë të gjitha lëndët sipas zhvillimit të programit të obliguar studimor. Pjesëmarrja në ligjërata është e obligueshme dhe paraqet kusht primar që ta kalojnë lëndën me sukses. Çdo lëndë duhet të përfundojë, duke i plotësuar kërkesat e parashtruara në program (syllabusin) e lëndës.

Të gjitha drejtimet e Fakultetit Ekonomik në formë unike i përgatisin studentët për pozita udhëheqëse në të gjithë botën, si në organizatat fitimprurëse, po ashtu edhe në ato jofitimprurëse. Këto studime pritet të japin rezultate profesionale, të përshtatshme me kërkesat e tregut të punës dhe, njëkohësisht shërbejnë si bazë e shëndoshë për studimet të mëtutjeshme në nivelin pasuniversitar. Sot, shumë organizata funksionojnë në nivel global. Për këtë arsye, programet janë të ndërtuara të ofrojnë qasje integruese të çështjeve të biznesit ndërkombëtar, duke përfshirë koncepte të biznesit ndërkombëtar gjatë tërë programit studimor të biznesit. Lëndët në programet prezantojnë perspektivë të bazuar në teori, që janë të lidhura ngushtë me aplikimin e tyre në



botën e biznesit. Programet kanë si pikënisje aftësimin e studentëve me njohuri të përgjithshme të gjuhëve lokale dhe angleze, aftësive të teknologjive informative (TI), studimeve evropiane, metodologjinë kërkimore dhe aftësitë e studimit. Pastaj, studentët njoftohen me lëndët themelore të ekonomisë dhe të menaxhimit të biznesit dhe më në fund fokusohen në lëndët e avancuara profesionale, si manaxhmenti financiar, marketingu, e-biznesi dhe lëndët zgjedhore të avancuara. Eksperienca e kombinuar profesionale dhe akademike e stafit të fakultetit tonë u përgjigjet sfidave të rrethanave të biznesit dhe ‘ekonomisë së re’. Përfitim plotësues është se, studentët në semestrin e fundit janë të nxitur të marrin pjesë në punë praktike, me ç’rast u jepet mundësia të njoftohen me botën reale të biznesit. Eksperienca e fituar gjatë punës praktike u lejon atyre të jenë në rrjedha me kolegët e tyre në botën e biznesit në Evropë dhe botë, si dhe për të bërë vetëvlerësimin e kompetencave dhe aftësive personale.

Ndërkaq, meqë programet bazohen në akumulim të kredive nga modulet e përfshira në program, ato lejojnë akumulim të kredive nga universitetet tjera/mundësojnë transfer në program të vitit të dytë dhe në vitin e fundit të studimeve. Qasja e tillë bashkëkohore në mësimdhënie dhe pajisjet për mësim u përgjigjen standardeve të universiteteve të njohura në botë. Studentët tanë kanë bibliotekë të furnizuar mirë dhe laborator me dhjetëra kompjuterë me linjë interneti. Departamentet bashkëpunojnë me shumë organizata serioze të suksesshme në vend, në bazë të autoritetit që ka UT-ja dhe me ekzistimin e qendrave të biznesit dhe Qendrës së Karrierës, që mban lidhje të vazhdueshme afatgjate me shumë organizata serioze dhe të suksesshme në vend. Një aktivitet i tillë i pozicionon të diplomuarit tanë një hap para në tregun e punës duke u mundësuar lehtësim në punësim dhe aplikim të njohurive të fituara në fushat përkatëse. Të diplomuarit do të kenë mundësi të punësohen në organizata të sektorit publik dhe privat, në sferën e funksioneve të biznesit, si udhëheqës, këshilltarë, administratorë, analistë financiarë, kontabilistë, udhëheqës të burimeve njerëzore, udhëheqës në marrëdhëniet publike, udhëheqës marketingu, studiues tregu dhe shumë pozita tjera sfiduese. Diploma, gjithashtu, ofron bazë për ndjekjen e studimeve pasuniversitare në shumë universitete të akredituara dhe shkolla të biznesit nëpër botë

## **4. PROGRAMET STUDIMORE TË FAKULTETIT EKONOMIK**

### ***Bashkëpunimi me kompanitë/institucionet në nivel të programeve studimore***

Programi studimor Ekonomi dhe Biznes ka marrëveshje bashkëpunimi me 15 kompani prej të cilave tre janë të sektorit publik. Rreth 47% e kompanive kontribuojnë plotësisht në realizimin e mësimit praktik të studentëve si dhe 53% e kompanive kontribuojnë pjesërisht në realizimin e mësimit praktik të tyre. Prej këtyre kompanive 60% janë burim i mundshëm i vendit të punës, kurse 40% janë pjesërisht burim i mundshëm i vendit të punës.

Programi studimor Financa dhe Kontabilitet realizon bashkëpunimin me 15 kompani prej të cilave 3 janë të sektorit publik. Rreth 60% e kompanive kontribuojnë plotësisht në realizimin e mësimit praktik të studentëve. Prej këtyre kompanive 33% janë burim i mundshëm i vendit të punës dhe 67% janë pjesërisht burim i mundshëm i vendit të punës. Në kuadër të këtij programi studimor vlerësohet se duhet të vendosen marrëdhënie bashkëpunimi edhe me 5 kompani tjera publike (Drejtoria e të Ardhurave Publike, Regjistri Qendror i RMV-së, Agjencioni për Punësim i RMV-së, Drejtoria Doganore e RMV-së, BNJVL).

### ***Programi studimor Ekonomi dhe Biznes***

Studentët, pas përfundimit të studimeve, aftësohen për ndërmarrjen e iniciativave në zbulimin dhe krijimin e sfidave afariste dhe mund të zhvillojnë karrierë profesionale në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe menaxhmentit, që kërkojnë inovacion, ndërmarrje të riskut dhe orientim drejt tregtimit.

### ***Programi studimor Kontabilitet dhe Financa***

Ky program studimor u mundëson studentëve kompetenca të fituara për kryerjen e punëve të larta profesionale nga fusha e kontabilitetit, revizionit dhe vendimmarrjes financiare, në të gjithë sektorët ekonomikë: sektori financiar (banka, kompani sigurimesh, fonde për investim,

fonde pensionale), sektori profitabil (subjektet prodhuese, tregtare dhe shërbyese), shtëpive të revizionit, sektori publik etj..

### ***Programi studimor Marketing - Menaxhment***

Mundëson sukses në realizimin e punëve në lëmin e veprimtarisë strategjike, komunikim në marketing, shërbime dhe ide, shitje, marrëdhënie me publikun, hulumtime në treg, etj., edhe atë në: ndërmarrje, institucione, agjenci të specializuara, marketing ndërkombëtar.

### ***Programi studimor Turizëm***

Programi studimor, përpos përfitimit të diturive akademike universitare nga lëmi i turizmit dhe menaxhmentit turistik, mundëson zhvillimin e aftësive për kryerjen e punëve në lëmin e turizmit dhe resurseve natyrore, aftësi për punë në procesin arsimor, si profesor i turizmit ose menaxher i turizmit dhe të ngjashme.

### ***Programi studimor Biznes Ndërkombëtar***

Nëpërmjet këtij programi synohet që studentët të pajisen me njohuri për njohjen dhe operimin e bizneseve në aspektin ndërkombëtar si dhe të punësimit të studentëve të ekonomisë në kompani ndërkombëtare të cilat operojnë në vendin tonë.

Rëndësia e programeve rritet pasi që të gjitha programet e lartpërmendura ofrojnë:

- Programe të akredituara (konform procesit të Bolonjës), që janë të pranuar në nivel nacional dhe ndërkombëtar;
- Ofrojnë ambient dinamik dhe intelektual që stimulon aktivitet mësimor për të gjitha departamentet dhe studentët;
- Stimulim i kreativitetit, inovacioneve, cilësisë dhe studimit të qëndrueshëm;

- Staf akademik me përvojë kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Përmirësim të organizimit, administrimit dhe udhëheqjes duke zbatuar standardet evropiane.

### ***Vlerësimi i plan-programit aktual në nivel të programeve studimore***

#### ***Programi studimor Ekonomi dhe Biznes***

- Në kuadër të programit studimor Ekonomi dhe Biznes rreth 90 % e lëndëve obligative dhe zgjedhore janë plotësisht dhe ose pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit.
- Në të gjitha lëndët (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara për to janë plotësisht në përputhshmëri me deskriptoret për zhvillim të kompetencave të programit studimor.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Ekonomi dhe Biznes relativisht përfshin një kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve në përjashtim të 6 lëndëve të cilat janë pjesërisht të vendosura në semestrin e duhur dhe 3 lëndë që aspak nuk janë të vendosura në të njëjtin semestër ose u paraprijnë lëndëve, njohuritë e të cilave duhet t'i mbindërtojnë.
- Aktivitetet e planifikuara me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse në të gjitha lëndët janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.
- Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit nga shkenca si përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, rreth 49% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë që gjatë akreditimit

të ardhshëm të azhurnohen me qëllim të plotësimit të kërkesave bashkëkohore dhe arritjeve në fushën e ekonomisë dhe biznesit.

### ***Programi studimor Financa dhe Kontabilitet***

- Në kuadër të programit studimor Financa dhe Kontabilitet, rreth 75% e lëndëve janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, kurse rreth 18% janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas këtij klasifikimi.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Financa dhe Kontabilitet është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve. Prej lëndëve obligative, 9 lëndë janë pjesërisht të vendosura në semestrin e duhur dhe 2 lëndë aspak nuk janë të vendosura në të njëjtin semestër ose u paraprijnë lëndëve njohuritë e të cilave duhet t'i mbindërtojnë.
- Aktivitetet e planifikuara me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse, në 86% të lëndëve janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.
- Lëndët në kuadër të programit studimor Financa dhe Kontabilitet përgjithësisht nxisin zhvillimin e shkathtësive të cilat janë të aplikueshme në treg të punës. Megjithatë, me qëllim të avancimit të kompetencave, por edhe rritjen e efikasitetit të kuadrove të reja në fushën e biznesit, rreth 56% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë për azhurnim sepse nxisin pjesërisht shkathtësi të cilat janë të aplikueshme në treg të punës sipas kërkesave bashkëkohore.

## ***Programi studimor Marketing - Menaxhment***

- Në kuadër të programit studimor Marketing - Menaxhment, rreth 75% e lëndëve obligative dhe 14% e lëndëve zgjedhore janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit.
- Vendosija kronologjike e lëndëve të programit studimor Marketing - Menaxhment relativisht vështirëson zhvillimin dhe mbindërtimin e njohurive dhe shkathtësive të studentëve.
- Aktivitetet e planifikuara me të cilat angazhohen studentët në drejtim të përfitimit të kompetencave përkatëse në 50% të lëndëve obligative dhe 32 % të lëndëve zgjedhore pjesërisht janë në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.

## **5. VEPRIMTARIA MËSIMORE**

### **5.1. Struktura e kuadrit mësimor**

Në Fakultetin Ekonomik procesin mësimor në vitin akademik 2016/17 e kanë realizuar gjithsej 36 mësimdhënës me kohë të plotë dhe 7 me kohë të pjesshme. Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit në Fakultetin Ekonomik realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit të Tetovës. Në vitin akademik 2016/2017 në Fakultetin Ekonomik kanë qenë të punësuar 21 mësimdhënës dhe 15 bashkëpunëtorë dhe asistentë të rregullt.

Tabela 1. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2016-17

NR.	THIRRJA	Statusi i punës		Gjinia	
		Rregullt	Part – time	M	F
1.	ORDINAR	2	/	2	/
2.	INORDINAR	6	/	6	/


3.	DOCENT	13	1	6+1	7
4.	ASISTENT	15	6	5+3	10+3
5.	DEMONSTRATOR	/	/	/	/

Nëse analizojmë proporcionin gjinor të stafit akademik gjatë këtij viti, vërejmë se 7 mësimdhënëse dhe 13 asistente janë të gjinisë femërore kurse 15 mësimdhënës dhe 8 asistentë janë të gjinisë mashkullore. Kjo ka të bëjë edhe me nivelin e arsimit të gjinisë femërore në tërësi në bashkësinë tonë, megjithatë përfshirja solide e gjeneratave të reja të gjinisë femërore kontribuon që marrë në tërësi, të krijohet një balancim gjinor i stafit akademik në Fakultetin Ekonomik. Megjithatë, për të ruajtur nivelin e kualitetit si dhe njëkohësisht për të kontribuar në mbarëvajtjen efektive dhe produktive të procesit të mësimdhënies në Fakultetin Ekonomik janë angazhuar edhe 7 mësimdhënës me kontratë, respektivisht 1 profesor dhe 6 asistentë. Për sa i përket përgatitjes profesionale dhe titujve akademikë, siç mund të vëreni në grafikun më poshtë nga stafi i rregullt 5% janë profesorë ordinarë, 11% janë profesorë inordinarë, 36% janë me titull akademik docentë, 48% janë asistentë.

Grafiku 1. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë dhe akademikë

## Profesorët

■ ORDINAR ■ INORDINAR ■ DOCENT ■ BASHKPUNTORË ■ ASISTENT



Sa i përket procesit mësimor në vitin akademik 2017/18, e kanë realizuar gjithsej 35

15

mësimdhënës me kohë të plotë dhe 9 me kohë të pjesshme. Në vitin akademik 2017/2018 në Fakultetin Ekonomik kanë qenë të punësuar 25 mësimdhënës dhe 10 asistentë të rregullt. Të dhënat mund t'i paraqesim në tabelën me poshtë:

Tabela 2. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2017-18


NR.	THIRRJA	Statusi i punës		Gjinia	
		Rregullt	Part – time	M	F
1.	ORDINAR	2	/	2	/
2.	INORDINAR	8	/	8	/
3.	DOCENT	15	1	5+1	10
4.	ASISTENT	10	8	3+3	7+5
5.	DEMONSTRATOR	/	/	/	/

Nëse analizojmë proporcionin gjinor të stafit akademik gjatë këtij viti, vërejmë se nga këto 11 mësimdhënës dhe 12 asistentë janë të gjinisë femërore kurse 17 mësimdhënës dhe 8 asistentë janë të gjinisë mashkullore. Kjo ka të bëjë edhe me nivelin e arsimimit të gjinisë femërore në tërësi në bashkësinë tonë, megjithatë përfshirja solide e gjeneratave të reja të gjinisë femërore kontribuon që marrë në tërësi, të krijohet një balancim gjinor i stafit akademik në Fakultetin Ekonomik. Megjithatë, për të ruajtur nivelin e kualitetit si dhe njëkohësisht për të kontribuar në mbarëvajtjen efektive dhe produktive të procesit të mësimdhënies në Fakultetin Ekonomik janë angazhuar edhe 13 mësimdhënës me kontratë, respektivisht 2 profesorë dhe 11 asistentë. Për nga përgatitja profesionale dhe titujt akademikë, siç mund të vëreni në grafikun më poshtë nga stafi i rregullt 6% janë profesorë ordinarë, 23% janë profesorë inordinarë, 43% janë me titull akademik docent, 28% janë asistentë. Siç mund të vëreni gjatë këtij viti kemi avancim në tituj shkencorë të stafit të brendshëm.



Grafiku 2. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë dhe akademikë

## Profesorët 2017/2018



Sa i përket procesit mësimor në vitin akademik 2018/19, e kanë realizuar gjithsej 35 mësimdhënës me kohë të plotë dhe 13 me kohë të pjesëshme. Në vitin akademik 2018/2019 në Fakultetin Ekonomik kanë qenë të punësuar 25 mësimdhënës dhe 10 bashkëpunëtorë dhe asistentë të rregullt.

Tabela 3. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2018-19


NR.	Thirrja	Statusi i punës		Gjinia	
		Rregullt	Part - time	M	F
1.	ORDINAR	2	/	2	/
2.	INORDINAR	8	/	8	/
3.	DOCENT	17	2	5+2	11
4.	ASISTENT	8	9	3+4	6+5
5.	DEMONSTRATOR	/	2	+1	+1

Nëse analizojmë proporcionin gjinor të stafit akademik gjatë këtij viti, vërejmë se 11 mësimdhënës dhe 12 asistente janë të gjinisë femërore, kurse 17 mësimdhënës dhe 8 asistentë janë të gjinisë mashkullore. Kjo ka të bëjë edhe me nivelin e arsimit të gjinisë femërore në

tërësi në bashkësinë tonë, megjithatë përfshirja solide e gjeneratave të reja të gjinisë femërore kontribuon që marrë në tërësi, të krijohet një balancim gjinor i stafit akademik në Fakultetin Ekonomik. Megjithatë, për të ruajtur nivelin e kualitetit si dhe njëkohësisht për të kontribuar në mbarëvajtjen efektive dhe produktive të procesit të mësimdhënies në Fakultetin Ekonomik janë angazhuar edhe 13 mësimdhënës me kontratë, respektivisht 2 profesorë dhe 11 asistentë. Për nga përgatitja profesionale dhe titujt akademikë, siç mund të vëreni në grafikun më poshtë nga stafi i rregullt 6% janë profesorë ordinarë, 23% janë profesorë inordinarë, 48% janë me titull akademik docent, 23% janë asistentë.

Grafiku 3. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë dhe akademikë

### Profesorët 2018/19



## 6. STRUKTURA E STUDENTËVE

### 6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara në vitin akademik 2016/2017, në drejtimin K-F 50 studentë janë me status të rregullt kurse 25 me korrespondencë prej të cilëve 41 femra dhe 34 meshkuj; në drejtimin M-M 38 studentë janë me status të rregullt kurse 10 me korrespondencë, prej të cilëve 21 femra dhe 28 meshkuj; në drejtimin E-B 48 studentë janë me status të rregullt kurse 14 me korrespondencë, prej të cilëve 27 femra dhe 35 meshkuj; në drejtimin Turizëm 23 studentë janë me status të rregullt kurse 2 me korrespondencë, prej të cilëve 2 femra dhe 23 meshkuj; në drejtimin Biznes Ndërkombëtar 16 studentë janë me status të rregullt kurse 2 me korrespondencë prej të cilëve 6 femra dhe 12 meshkuj.

Tabela 4. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor KF

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Korrespondencë	Nr. i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2016-2017	34	41	50	25	75	39
2017-2018	14	30	35	9	44	18
2018-2019	13	20	32	1	33	50

Sa i përket strukturës gjinore të studentëve në drejtimin Kontabilitet-Financa, në vitin akademik 2016/17 ka pasur 56% femra, 44% meshkuj, në vitin 2017/18 ka pasur 68% femra dhe 32% meshkuj dhe në vitin 2018/19 ka pasur 60.6% femra dhe 39.4% meshkuj në studimet baçelor.

Grafiku 4. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor KF



Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara në vitin akademik 2017/2018, në drejtimin K-F, 35 studentë janë me status të rregullt dhe 9 studentë me korrespondencë prej të cilëve 30 femra dhe 14 meshkuj; në drejtimin M-M 27 studentë janë me status të rregullt dhe 4 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 13 femra dhe 18 meshkuj, në drejtimin E-B 35 studentë janë me status të rregullt dhe 4 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 15 femra dhe 24 meshkuj; në drejtimin Turizëm 26 studentë janë me status të rregullt dhe 5 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 13 femra dhe 18 meshkuj; në drejtimin Biznes Ndërkombëtar 12 studentë janë me status të rregullt dhe 4 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 8 femra dhe 8 meshkuj.


Tabela 5. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Marketing - Menaxhment

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Korrespondencë	Numri i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2016-2017	28	21	38	10	49	8

2017-2018	18	13	27	4	31	2
2018-2019	22	27	42	7	49	4

Sa i përket strukturës gjinore të studentëve në drejtimin Marketing - Menaxhment, në vitin akademik 2016/17 ka pasur 42.8% femra 57.2% meshkuj; në vitin akademik 2017/18 ka pasur 41.9% femra dhe 58.1% meshkuj dhe në vitin akademik 2018/19 ka pasur 55.1% femra dhe 44.9% meshkuj në studimet baçelor.

Grafiku 5. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Marketing - Menaxhment



Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara në vitin akademik 2018/2019, në drejtimin K-F 32 studentë janë me status të rregullt dhe 1 student me korrespondencë prej të cilëve 20 femra dhe 13 meshkuj; në drejtimin M-M 42 studentë janë me status të rregullt dhe 7 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 27 femra dhe 22 meshkuj; në drejtimin E-B 24 studentë janë me status të rregullt dhe 4 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 15 femra dhe 13 meshkuj; në drejtimin Turizëm 11 studentë janë me status të rregullt dhe 3 studentë me korrespondencë, prej të cilëve 2 femra dhe 12 meshkuj; në drejtimin BN 11

studentë janë me status të rregullt dhe 1 student me korrespondencë, prej të cilëve 4 femra dhe 8 meshkuj.

Tabela 6. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor EB

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Korrespondencë	Numri i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2016-2017	35	27	48	14	62	/
2017-2018	24	15	35	4	39	/
2018-2019	13	15	24	4	28	/

Sa i përket strukturës gjinore të studentëve në drejtimin Ekonomi Biznes, në vitin akademik 2016/17 ka pasur 43.5% femra dhe 56.5% meshkuj, në vitin akademik 2017/18 ka pasur 38.4% femra dhe 61.6% meshkuj dhe në vitin akademik 2018/19 ka pasur 53.5% femra dhe 46.5% meshkuj në studimet baçelor.

Grafiku 6. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Ekonomi Biznes




Tabela 7. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Turizëm

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Korrespondencë	Numri i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2016-2017	23	2	23	2	25	8

2017-2018	18	13	26	5	31	2
2018-2019	12	2	11	3	14	4

Sa i përket strukturës gjinore të studentëve në drejtimin Turizëm, në vitin akademik 2016/17 ka pasur 8% femra, 92% meshkuj, në vitin 2017/18 ka pasur 41.9% femra dhe 57.1% meshkuj dhe në vitin akademik 2018/19 ka pasur 14.2% femra dhe 85.8% meshkuj në studimet baçelor.

Grafiku 7. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Turizëm




Tabela 8. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Biznes Ndërkombëtar

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Korrespondencë	Nr. i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2016-2017	12	6	16	2	18	/
2017-2018	8	8	12	4	16	/
						/
2018-2019	8	4	11	1	12	/

Sa i përket strukturës gjinore të studentëve në drejtimin Biznesi Ndërkombëtar në vitin akademik 2016/17 ka pasur 33.3% femra 66.7% meshkuj, në vitin akademik 2017/18 ka pasur 50% femra dhe 50% meshkuj dhe në vitin akademik 2018/19 ka pasur 33.3% femra dhe 66.7% meshkuj në studimet baçelor.

Grafiku 8. Struktura gjinore e studentëve në programin studimor Biznes Ndërkombëtar



## 6.2. Struktura e studentëve në ciklin e dytë të studimeve (master)

Në vitin akademik 2016/17 në studimet e ciklit të dytë master janë regjistruar gjithsej 21 studentë vendas dhe 3 studentë shtetas të huaj prej të cilëve 1 në drejtimin Ekonomi-Biznes, 8 në drejtimin Financa dhe Kontabilitet, 2 Kontabilitet dhe Revizion, 9 në drejtimin Marketing - Menaxhment(3+2), 3 në drejtimin Marketing - Menaxhment(4+1) dhe 1 student në drejtimin Turizëm.

Tabela 9. Numri i studentëve në ciklin e dytë sipas programeve studimore në vitin akademik 2016-17


Numri Rendor	Programi studimor	Drejtimi	Të rregullt	Shtetas të huaj	Gjithsej
1	3+2	EKONOMI - BIZNES	1	/	1
2	3+2	FINANCA DHE	8	/	8



		KONTABILITET			
3	4+1	KONTABILITET DHE REVIZION	1	1	2
4	3+2	MARKETING DHE MENAXHMENT	9		9
5	4+1	MARKETING DHE MENAXHMENT	2	1	3
6	3+2	TURIZËM		1	1
			21	3	24

Grafiku 9. Struktura e studentëve në ciklin e dytë sipas shtetësisë në vitin akademik 2016-17

## TË RREGULLT- TË HUAJ (2016/2017)



Në vitin akademik 2016/17 në studimet e ciklit të dytë (master) janë regjistruar gjithsej 17 studentë vendas dhe 6 studentë shtetas të huaj prej të cilëve 5 në drejtimin Financa dhe Kontabilitet, 9 Financa, Banka dhe Sigurime, 3 Kontabilitet dhe Auditim, 1 në drejtimin Marketing, 4 në drejtimin Marketing-Menaxhment dhe 1 student në drejtimin Menaxhment.


25

Tabela 10. Numri i studentëve në ciklin e dytë sipas programeve studimore në vitin akademik 2017-18

Nr.	Programi studimor	Drejtimi	Të rregullt	Shtetas të huaj	Gjithsej
1	3+2	FINANCA DHE KONTABILITET	2	3	5
2	4+1	FINANCA BANKA DHE SIGURIME	8	1	9
3	4+1	KONTABILITET DHE AUDITIM	3		3
4	4+1	MARKETING	1		1
5	3+2	MARKETING DHE MENAXHMENT	2	2	4
6	4+1	MENAXHMENT	1		1
			17	6	23

Grafiku 10. Struktura e studentëve në ciklin e dytë sipas shtetësisë në vitin akademik 2017-18

### TË RREGULLT-TË HUAJ (2017/2018)




Në vitin akademik 2018/19 në studimet e ciklit të dytë (master) janë regjistruar gjithsej 23 studentë vendas dhe 3 studentë shtetas të huaj prej të cilëve 16 studentë janë regjistruar në drejtimin Financa, Banka dhe Sigurime, 1 Kontabilitet dhe Auditim, 4 Financa dhe Kontabilitet, 2 në drejtimin Marketing, 3 në drejtimin Marketing - Menaxhment.

Tabela 11. Numri i studentëve në ciklin e dytë sipas programeve studimore në vitin akademik 2018-19

N r	Programi studimor	Drejtimi	Të rregullt	Shtetas të huaj	Gjithsej
1	4+1	FINANCA BANKA DHE SIGURIME	15	1	16
2	3+2	FINANCA DHE KONTABILITET	3	1	4
3	4+1	KONTABILITET DHE AUDITIM	1		1
4	3+2	MARKETING DHE MENAXHMENT	2	1	3
5	4+1	MARKETING	2		2
			23	3	26

Grafiku 11. Struktura e studentëve në ciklin e dytë sipas shtetësisë në vitin akademik 2018-19

### TE RREGULLT/ TË HUAJ (2018-2019)



### 6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës

Në studimet e ciklit të tretë, Fakulteti për herë të parë ka regjistruar studentë në vitin akademik 2017/18 në drejtimet Financa dhe Marketing. Gjithsej janë regjistruar 12 studentë prej të cilëve 6 studentë në drejtimin Financa (2 meshkuj dhe 4 femra) dhe 6 studentë në drejtimin Marketing (4 meshkuj dhe 2 femra).

Tabela 12. Numri i studentëve në ciklin e tretë të studimeve (doktoratë) 2017/18

Programet studimore	Drejtimet	Numri i studentëve M	Numri i studentëve F	Gjithsej
Shkenca ekonomike	Financa	2	4	6
	Marketing	4	2	6
	Ekonomi e Aplikuar	0	0	0
<b>Gjithsej</b>		<b>6</b>	<b>6</b>	<b>12</b>

## 7. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve hulumtuese, Fakulteti Ekonomik organizon konferenca shkencore me bord editorial nga pedagogë vendas dhe pedagogë me të cilët Universiteti ynë ka bashkëpunim të ndërsjellë dhe boton revistën shkencore “Economic Vision” me bord nga pedagogë vendas dhe të huaj. Vijueshmëria aktive si pjesëmarrës dhe organizatorë të konferencave dhe tryezave të rrumbullakëta të stafit ka rezultuar me prezantime të suksesshme të arritjeve shkencore dhe me bashkëpunime të ardhshme në hulumtime shkencore mes pedagogëve të universitetit tonë dhe universiteteve tjera. Po ashtu organizimet e

konferencave kanë mundësuar shkëmbim të stafit të Fakultetit Ekonomik dhe fakulteteve tjera sidomos për ciklet e studimit të nivelit të dytë dhe të tretë.

Më 2.12.2016 Fakulteti Ekonomik organizoi Konferencën IV Shkencore me temë “The Economic Effects of Migration Processes in the Western Balkan”; më 1.12.2017 Fakulteti Ekonomik organizoi Konferencën V Shkencore me temë “Challenges of Doing Business in the Contemporary World”; më 19-20.11.2018 Fakulteti Ekonomik organizoi Konferencën VI Shkencore me temë “Economic Development as a Precondition for EU Integration” dhe më 13-15.11.2019 Fakulteti Ekonomik organizoi Konferencën VII Shkencore me temë “Contemporary Economic Trends”. Në të gjitha konferencat e lartpërmendura referuan një numër i madh profesorësh, studiuesish nga vendi, rajoni dhe më gjerë.

Fakulteti Ekonomik, në prill të vitit 2018 ka organizuar debatin shkencor “Përcaktimi i prioritetëve të zhvillimit ekonomik në Republikën e Maqedonisë” kurse në prill të vitit 2019 debatin shkencor “Sfidat e zhvillimit ekonomik të destinacionit turistik të Kodrës së Diellit”. Në të dy debatet shkencore referuan dhe morën pjesë profesorë, përfaqësues të pushtetit qendror dhe lokal dhe grupet e interesit.


Tabela 13. Revistat shkencore të publikuara nga Fakulteti Ekonomik gjatë viteve akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019

<b>TITULLI I REVISTES</b>	<b>VOLUMI, VITI</b>
ECONOMIC VISION International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism	(Vol.4.No.7&8 pp.1-205) 2017
ECONOMIC VISION International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism	(Vol.5.No.9&10 pp.1-181) 2018

ECONOMIC VISION International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism	(Vol.6.No.11&12 pp. 1-200 ) 2019
--	----------------------------------


Në revistën shkencore “Economic Vision” të Fakultetit Ekonomik në vitin 2017 u botua volumi IV dhe numri 7-8, ku u publikuan 21 punime shkencore, në vitin 2018 volumi V dhe numri 9-10 ku u publikuan 20 punime shkencore dhe në vitin 2019 u botua volumi VI dhe numri 11-12 ku u publikuan 21 punime shkencore.

Grafiku 12. Punimet e botuara në revistën shkencore “Economic Vision” sipas autorëve



Në botimin e vitit 2017 të revistës shkencore “Economic Vision” punimet e veta i botuan 15 autorë vendas dhe 6 autorë të huaj; në botimin e vitit 2018 punimet e veta i botuan 17 autorë vendas dhe 3 autorë të huaj dhe në botimin e vitit 2019 punimet e veta i botuan 18 autorë vendas dhe tre autorë të huaj.

Grafiku 13. Punimet shkencore të botuara në revistën shkencore Economic Vision sipas fushave



Në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/2019 stafi akademik i Fakultetit Ekonomik ka botuar rreth 180 punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare. Përmes projektit CEEPUS, Fakulteti Ekonomik ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim akademik me Fakultetin Ekonomik të Suboticës, konkretisht bashkëpunimi përfshin realizimin e përbashkët të programeve studimore të tre cikleve të studimit; angazhimin e mësimeve dhe bashkëpunëtorëve me qëllim të realizimit të programeve studimore; si dhe shkëmbim të materialit studimor dhe të literaturës profesionale, librave dhe publikimeve universitare; bashkëpunim në projekte kërkimore - shkencore, por edhe në fushën e edukimit dhe aftësimin profesional. Zbrazëtirat e literaturës akademike për nevojat e studentëve dhe për të qenë në paralele me ndryshimet në programet dhe me trendet botërore ngushtohen për shkak të kontributit shkencor të pedagogëve të brendshëm edhe atë në fushën e ekonomisë, financave, marketingut.

## ***Botimet e teksteve universitare***

1. ArunTairi (2018)., *Ekonomia informale dhe fenomenet shoqëruese të saj*, Tetovë
2. Besa Xhaferi (2018)., *Hyrje në Ekonometri*, Prishtinë
3. ArunTairi (2019)., *Procesi i transformimit dhe privatizimit të pronës*, Prishtinë
4. Etem Iseni, Fekri Iseni (2017)., *Bazat e kontabilitetit*, Tetovë
5. Rametulla Ferati, Nedime Sallai (2018)., *Audit*, Tetovë
6. Rametulla Ferati, Nedime Sallai (2019)., *Audit-ushtrime*, Tetovë

Në periudhën e trajtuar është realizuar mobilitet i stafit edhe atë në Suedi, Britaninë e Madhe dhe Sllovaki. Në kuadër të ECTS, përveç shkëmbimeve të pedagogëve është realizuar edhe mobilitet i suksesshëm i studentëve, edhe atë dy studentë në universitete të Turqisë dhe një student në Rumani. Po ashtu për shkak të ndërlidhjes së teorisë me praktikën për 3 vjet rresht bëhet organizim i vizitës së studentëve në institucionet e Unionit Evropian. Pedagogët e Fakultetit Ekonomik në vazhdimësi dëshmojnë vlera dhe angazhohen me pjesëmarrje dhe të arritura në sferën shkencore edhe atë me vepra shkencore, cikle leksionesh, projekte, debate publike, vizita profesionale jashtë vendit si dhe me punime në revista ndërkombëtare dhe punime në revista me impakt faktor<sup>21</sup>.



## **8. REALIZIM I ORËS MËSIMORE NË PROGRAMET STUDIMORE TË FAKULTETIT EKONOMIK**

### **8.1. Anketimi i studentëve për realizim të orës mësimore në programet studimore të Fakultetit Ekonomik**

Gjate vitit akademik 2016-17 në programet studimore të Fakultetit Ekonomik është realizuar evaluim i orëve mësimore dhe gjithsej nga studentët janë plotësuar 370 pyetësorë. Rreth 96% e përgjigjeve në Fakultetin Ekonomik tregojnë se ligjëratat fillojnë saktë sipas orarit, kurse rreth 80% se ligjëratat mbarojnë në kohën e paraparë sipas orarit të shpallur. Përqindja më e madhe e studentëve që deklarojnë se ligjëratat fillojnë dhe mbarojnë sipas orarit të paraparë janë në programin studimor Kontabilitet - Financa (98%) dhe Marketing - Menaxhment (97%).

Rreth 56% e studentëve në Fakultetin Ekonomik deklarojnë se gjatë ligjëratës kanë bërë pauzë 10 deri 15 minuta. Sipas programeve studimore në Ekonomi - Biznes numri më i madh i studentëve (rreth 89%) deklarojnë se gjatë ligjëratave bëjnë pauzë 10 deri 15 minuta. Pastaj vijojnë studentët e programit studimor Marketing - Menaxhment me rreth 85%, studentët e programit studimor Kontabilitet - Financa diku (rreth 66%).

Për realizim të orëve gjatë ligjëratave në Fakultetin Ekonomik përdoren mjete të ndryshme për prezantim. Studentët deklarojnë rreth (50%) se gjatë ligjëratës mësimdhënësit kanë përdorur Power Point prezantime, kurse rreth 31% e studentëve deklarojnë se përdoret tekst në dërrasë, dhe diku rreth (12%) deklarojnë se gjatë ligjërimit mësimdhënësit nuk përdorin asnjë mjet për të realizuar ligjëratën. Përqindja më e madhe e studentëve të cilët deklarojnë se mësimdhënësit përdorën Power Point për prezantim me përqindje më të madhe diku (78%) janë studentët e programit studimor Ekonomi - Biznes dhe rreth (68%) janë studentët e programit studimor Marketing - Menaxhment.

## 8.2. Realizimi i ligjëratave

Studentët e kanë vlerësuar realizimin e orës në lëndë të caktuara nëpërmjet shtatë pyetjeve. Në kuadër të Fakultetit Ekonomik, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e orës me të gjitha pyetjet. Edhe atë vlerësim më pozitiv kanë dhënë për sigurinë, bindshmërinë dhe qartësinë e mësimdhënësve gjatë ligjërimit (M= 4.53; M=4.35; M=4.39). Që të tria karakteristikat e mësimdhënësve janë vlerësuar si dominonte pozitive në të gjitha programet studimore të Fakultetit Ekonomik (tabela 1).

Tabela 14. Mesataret e indikatorëve të realizimit të ligjëratave

	Tema në përputhshmëri me ligjëratat	Ligjëratat të qarta	Ligjërues i sigurt	Ligjërues bindës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
<b>Marketing Menaxhment</b>	4.12 (71)	4.31(71)	4.43 (71)	4.31 (71)
<b>Financa Kontabilitet</b>	3.84 (193)	4.36(193)	4.57 (193)	4.46 (193)
<b>Turizëm</b>	4.19 (42)	4.26 (42)	4.61(42)	4.47 (42)
<b>Ekonomi Biznes</b>	4.63 (64)	4.42 (64)	4.47 (64)	4.23(64)

*Përmbajtja e ligjërimit/prezantimit* është vlerësuar nëpërmjet 14 pohimeve në të cilat janë përgjigjur me pesë opsione të mundshme, prej aspak nuk pajtohem(1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët kanë deklaruar se materiali i prezantuar gjatë ligjërimit ka qenë në përputhshmëri me temën e prezantuar në fillim të orës (M=4.36), mësimdhënësit pyesin për paqartësi (M=4.33) dhe se studentët e kanë pasur të qartë në çka duhet të fokusohen për t’u përgatitur në temën konkrete (M=4.03), ndërsa vlerësimi nën mesatar është për indikatorin “orientim i mjaftueshëm për burime shtesë” (M=2.75%), si dhe “lidhshmëria e përmbajtjeve të prezantuara me përmbajtje

34

të lëndëve tjera” (M=2.64%). Sipas programeve studimore, studentët e drejtimit Ekonomi - Biznes si dhe studentët e programit studimor Turizëm me vlerësim më të ulët janë për “hapësirë për diskutim në fund të orës” (M=2.78).

Tabela 15. Mesataret e indikatorëve të mbajtjes së ligjëratave

	<b>Orientim në pikat kyçe të temës</b>	<b>Lidhshmëri me tema tjera</b>	<b>Ilustrim me shembuj i përmbajtjes</b>	<b>Lidhshmëri për përdorim të njohurive në praktikë</b>	<b>Motivon për pjesëmarrje aktive në ligjëratë</b>
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
Marketing Menaxhment	4.09 (71)	3.53 (71)	4.22 (71)	3.77 (71)	3.91 (71)
Financa Kontabilitet	4.05 (193)	3.54 (193)	3.98 (193)	3.81 (193)	3.96 (193)
Turizëm	3.57 (42)	3.45 (42)	4.05 (42)	3.62 (42)	3.83 (42)
Ekonomi Biznes	3.44 (64)	3.79 (64)	4.49 (64)	3.61 (64)	3.44 (64)

*Menaxhimi i orës* është vlerësuar nëpërmjet shtatë pohimeve. Përgjigjet e mundshme në të gjitha pohimet kanë lëvizur prej opsionit aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët në nivel të fakultetit japin vlerësime pozitive në pyetjet duke veçuar se nuk ka pasur zhurmë gjatë ligjëratës (M=1.32), në lidhje me menaxhimin e orës gjatë ligjëratës (M=3.77), kanë qenë të koncentruar në ligjëratë (M=3.79) dhe se mësimdhënësi në mënyrë aktive është i orientuar nga studentët (M=3.54) janë dukuri për të cilat ka më tepër hapësirë për përmirësim. Sipas programeve studimore, studentët e Kontabilitet - Financa, Marketing - Menaxhment ,

Turizëm si dhe Ekonomi - Biznes vlerësojnë se ka hapësirë edhe më shumë për pjesëmarrjen aktive të studentëve në diskutim (M=2.70, M=2.51, M=2.70, M=2.75) si dhe dukuria: *mësimdhënësi i dëgjoj në mënyrë aktive komentet e studentëve* ka hapësirë për përmirësim është vlerësim i studentëve të programit studimor Ekonomi - Biznes (M=2.90).

*Interaksionin joverbal* të mësimdhënësve studentët e kanë vlerësuar nëpërmjet dhjetë pohimeve, gjithashtu me pesë opsione të mundshme për përgjigje, edhe atë prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Në tërësi studentët vlerësojnë pozitivisht interaksionin e mësimdhënësve ndaj tyre gjatë realizimit të ligjëratës. Në përgjithësi studentët e Fakultetit Ekonomik vlerësojnë se janë të kënaqur me mënyrën e organizimit të ligjëratave (M=4.08) (Tabela 16).

Tabela 16. Mesataret e indikatorëve të interaksionit joverbal të mësimdhënësve me studentët

	<b>Dëgjoj në mënyrë aktive komentet e studentëve</b>	<b>Stimuloi për pjesëmarrje aktive në ligjëratë</b>	<b>Ishte i paanshëm gjatë diskutimit të studentëve</b>	<b>Mbajti koncentrimin e studentëve</b>	<b>Vëzhgim i balancuar ndaj gjithë studentëve</b>	<b>Të kënaqur nga realizimi i orës</b>
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
<b>Marketing Menaxhment</b>	3.59 (71)	2.51 (71)	3.97 (71)	3.61 (71)	3.63 (71)	3.75 (71)
<b>Financa Kontabilitet</b>	3.86 (193)	2.70 (193)	4.00 (193)	3.71 (193)	3.91 (193)	4.31 (193)
<b>Turizëm</b>	3.00(42)	2.70 (42)	3.54 (42)	4.15 (42)	4.24 (42)	4.05 (42)

<b>Ekonomi</b>	2.90 (64)	2.75 (64)	3.03 (64)	4.02(64)	4.50 (64)	(64)
<b>Biznes</b>						

## 9. SWOT ANALIZA DHE KONKLUZIONI

<b>Strengths: Fuqitë</b>	<b>Opportunities: Mundësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Statistika të besueshme në dispozicion</li> <li>✓ Procedura të qarta të regjistrimit të semestrave;</li> <li>✓ Zhvillim i vazhdueshëm i strukturave të fakultetit;</li> <li>✓ Ndryshime të programeve studimore në përputhje me ndryshimet në trendet botërore;</li> <li>✓ Infrastrukturë e përshtatshme dhe klimë pozitive dhe kooperuese;</li> <li>✓ Programe kualitative akademike dhe shërbime studentore kualitative;</li> <li>✓ Siguri, bindshmëri dhe qartësi e mësimdhënësve gjatë ligjërimit;</li> <li>✓ Avancimi i vazhdueshëm i stafit akademik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Lidhja e botës akademike me biznesin;</li> <li>✓ Mundësi mobiliteti të stafit dhestudentëve;</li> <li>✓ Mundësi të lidhjes së teorisë me praktikën;</li> <li>✓ Bashkëpunime;</li> <li>✓ Memorandume.</li> </ul>
<b>Weaknesses: Dobësitë</b>	<b>Threats: Kërcënimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Financimi;</li> <li>✓ Numër i pamjaftueshëm i stafit akademik dhe administrativ;</li> <li>✓ Teknologjia informative.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Oferta e kuotave jo çdo vit përputhet me kërkesën;</li> <li>✓ Ndryshime të shpeshta të ligjeve dhe strategjive për punësim nga faktorë të jashtëm ;</li> <li>✓ Konkurrencë jolojale që funksionon pa implementim të standardeve të bazuara në Ligjin për arsim të lartë.</li> </ul>

Gjatë përgatitjes së raportit kemi hasur në bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme nga menaxhmenti, pedagogët dhe administrata e Fakulteti Ekonomik që flet për një klimë kooperuese dhe nivel komunikimi akademik të të gjitha hallkave në kuadër të Fakultetit Ekonomik.

SWOT analiza e Fakultetit Ekonomik nxjerr në sipërfaqe fuqitë, ku përfshihen:

- Statistika të besueshme në dispozicion;
- Procedura të qarta të regjistrimit të semestrave;
- Zhvillim i vazhdueshëm i strukturave të fakultetit;
- Ndryshime të programeve studimore në përputhje me ndryshimet në trendet botërore;
- Infrastrukturë të përshtatshme dhe klimë pozitive dhe kooperuese;
- Programe kualitative akademike dhe shërbime studentore kualitativ;
- Sigurinë, bindshmërinë dhe qartësinë e mësimeve gjatë ligjërimit;
- Avancimi i vazhdueshëm i stafit akademik.

### ***Mundësitë:***

- Lidhjen e botës akademike me biznesin
- Mundësi mobiliteti të stafit dhe studentëve
- Mundësi të lidhjes së teorisë me praktikën
- Bashkëpunime
- Memorandume

### ***Dobësitë:***

- Financimi;
- Numër i pamjaftueshëm i stafit akademik dhe administrativ;
- Teknologjia informative.

### ***Kërcënimet:***

- Oferta e kuotave jo çdo vit përputhet me kërkesën;
- Ndryshime të shpeshta të ligjeve dhe strategjive për punësim nga faktorë të jashtëm;
- Konkurrencë jolojale, që funksionon pa implementim të standardeve të bazuara në Ligjin për arsim të lartë.

***Komisioni për vetevaluim në Fakultetin Ekonomik:***

1. Prof. dr. Sali Zhaku - kryetar
2. Doc. dr. Besa Xhaferi - anëtar
3. Doc. dr. Lindita Muaremi - anëtar
4. Doc. dr. Elsana Aqifi - anëtar
5. Mr. sc. Jehona Musliu - anëtar
6. Xheneta Alili-anëtar (studente)
7. Elmedin Papraniku- anëtar (student).